



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

U D H Ë Z I M

Nr. 1, datë 22.01.2016

“PËR

PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT
SHTETËROR TË PULLËS POSTARE SHQIPTARE”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 6 të Ligjit Nr. 46 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 13 të VKM-së Nr. 1039, datë 16.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave për emetimin, prodhimin, dhe tregtimin e pullës postare shqiptare”,

U D H Ë Z O J:

Përcaktimin e rregullave për funksionimin e Komisionit Shtetëror të Pullës Postare Shqiptare (më poshtë referuar “Komisioni”) si më poshtë:

1. Komisioni ngrihet në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1039, datë 16.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave për emetimin, prodhimin, përdorimin dhe tregtimin e Pullës Postare Shqiptare”.
2. Komisioni ka për detyrë të miratojë tematikën vjetore të emisioneve të pullave postare shqiptare, si dhe të ndryshimeve në to, të shqyrtojë dhe miratojë bocetet fituese të emisioneve të pullave sipas parashikimeve në VKM-në nr. 1039, datë 16.12.2015.
3. Komisioni mbledhet të paktën një herë në 2 (dy) muaj dhe sa herë lind nevoja për probleme të veçanta ose kur kërkohet nga Posta Shqiptare sh.a.
4. Mbledhja e Komisionit thërret nga Kryetari, i cili përcakton datën dhe rendin e ditës së saj.
5. Njoftimi për mbledhjen e Komisionit duhet të bëhet të paktën 3 (tre) ditë përpara datës së përcaktuar me shkresë ose me postë elektronike. Çdo ndryshim për datën dhe kohën e vendosur për mbledhjen e radhës i njoftohet çdo anëtar të Komisionit të paktën 24 orë para mbledhjes, në mënyrë që ata të njihen me këto ndryshime.
6. Mbledhja për miratimin e tematikave vjetore bëhet brenda tremujorit të parë të çdo viti. Mbledhja për shqyrtimin dhe miratimin e boceteve bëhet me kërkesë të Posta Shqiptare sh.a.

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Këshilli i Ministrave

Tel: +355 4 2277355

E-mail: info@inovacioni.gov.al

pas përfundimit të procedurës së hapur të konkurrimit për bocetet për emisionet vjetore të pullave të kryer nga Posta Shqiptare sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 1039, datë 16.12.2015.

7. Punimet e boceteve paraqiten në mbledhjen e Komisionit nga specialisti i Pullës, përfaqësues i Postës Shqiptare sh.a. në zarfe të mbyllura, ku është shënuar vetëm numri i protokollit dhe data e marrjes në dorëzim nga Posta Shqiptare sh.a.
8. Komisioni, pas shqyrtimit të boceteve për çdo emision, vendos për çmimin e parë, të dytë dhe të tretë. Në përfundim të vlerësimit të boceteve, në prani të gjithë anëtarëve të Komisionit, përfaqësuesi i Postës Shqiptare sh.a., hap zarfin me emrat e autorëve të bocetave fitues, të cilët shënohen në procesverbalin e mbledhjes. Bocetet fitues firmosen nga kryetari i komisionit, duke shënuar datën dhe çmimin përkatës. Boceti fitues i çmimit të parë do të përdoret për prodhimin e pullës.
9. Mbledhja e Komisionit mund të zhvillohet vetëm nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të komisionit. Në mungesë të kuorumit, mbledhja zhvillohet në ditën pasuese, duke njoftuar me *e-mail* të gjithë anëtarët e Komisionit.
10. Në mbledhjen e Komisionit mbahet procesverbal, i cili mbahet në një regjistër të posaçëm nga Sekretari i Komisionit. Sekretari është anëtar, përfaqësues i Ministrisë në Komision.
11. Procesverbali i mbledhjes duhet të përmbajë:
 - a) datën dhe vendin e mbledhjes;
 - b) emrat e anëtarëve;
 - c) rendin e ditës;
 - d) çështjet që u diskutuan;
 - e) vendimet që u morën;
 - f) rezultatet e votimit pro, kundra apo abstenim.
12. Procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e pranishëm në fund të mbledhjes. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë të kërkojë kopje të procesverbalit të mbledhjes.
13. Në përfundim të çdo mbledhjeje, sekretari i komisionit, mbi bazën e procesverbalit të nënshkruar nga anëtarët, zbardh vendimin e Komisionit dhe ia kalon për firmë Kryetarit të Komisionit.
14. Komisioni merr vendime vetëm për çështje, të cilat janë përfshirë në rendin e ditës, përveç rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për çështje që nuk janë përcaktuar në rendin e ditës.
15. Komisioni mund të marrë një vendim të vlefshëm vetëm nëse janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm dhe, në rast barazimi votash, ajo e Kryetarit është përcaktuese.
16. Vendimi i Komisionit i dërgohet me shkrim për zbatim Postës Shqiptare sh.a., i shoqëruar me listën e prezencës së anëtarëve që morën pjesë në mbledhje me qëllim kryerjen e pagesës së tyre sipas parashikimeve të VKM-së nr. 1039, datë 16.12.2015.

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave

Tel: +355 4 2277355

E-mail: info@inovacioni.gov.al

17. Ngarkohet Komisioni Shtetëror i Pullës Postare Shqiptare dhe Posta Shqiptare sh.a. për zbatimin e këtij Udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Milena HARITO



Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave

Tel: +355 4 2277355

E-mail: info@inovacioni.gov.al